



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

Nr. 401/4 Prot.

Tiranë, më 18/09/2023

VENDIM

Nr. 24, DATË 18/09/2023

MBI

“FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MARRJEN E KANDIDATURAVE PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË MBARËVAJTJES SË VEPRIMTARISË DHE MARRËDHËNIEVE ME STUDENTËT NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në nenin 38, pika 1(i), në nenin 46, pikat 1, 2, 3 dhe 6 të ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 30, pikat 3 (c)/(d) dhe nenin 34 të Statutit të Universitetit të Arteve, në nenin 21, pikat 2 (c)/(d) dhe neni 26 të Rregullores së Universitetit të Arteve, në nenin 4, pika 1(s) të Rregullores së Funkcionimit të Senatit Akademik në Universitetin e Arteve si dhe Vendimit të Senatit Akademik për shkrirjen e Komisionit të Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Komisionit të Marrëdhënieve me Studentët në Universitetin e Arteve, me votim të hapur,

V E N D O S I:

1. Fillimin e procedurës për marrjen e kandidatave për anëtarë në Komisionin e Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët në Universitetin e Arteve.
2. Komisioni përbëhet nga 7 anëtarë, nga të cilët 3 janë anëtarë pjesë e personelit akademik (nga një anëtar për çdo fakultet të UART), 3 anëtarë përfaqësues të studentëve (nga një anëtar për çdo fakultet të UART) dhe 1 përfaqësues nga sektori mësimor dhe kurrikulës.
3. Anëtarët përfaqësues të studentëve dhe anëtarët përfaqësues të personelit akademik vetëkandidohen dhe zgjidhen nga Senati për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Përfaqësuesi nga sektori mësimor dhe i kurrikulës emërohet nga Rektori.
4. Aplikimet duhet të paraqiten pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore/P-A dhe afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve është data 26.04.2023.
5. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Artan PEQINI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Arben LLOZI

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Dr. Kastriot TUSHA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Endri SINA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Zamir KOKONOZI

Prof. Asoc. Genc FUGA

Erlind FUSHA (Student FAB)

Sindi ZDRAVA (Studente FM)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE DHE INFORMACIONIT, P/A

KËRKESË PËR KANDIDIM

**PËR ANËTAR TË KOMISIONIT TË MBARËVAJTJES SË
VEPRIMTARISË DHE MARRËDHËNIEVE ME STUDENTËT**

(STAF AKADEMIK)

Unë, i/e nënshkruar/i/a _____, lindur më ___/___/_____, në _____, të rrethit _____, gjinia _____, paraqes kërkesën time për të kandiduar për anëtar të Komisionit të Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët, në zgjedhjet e muajit prill 2023, si përfaqësues i Fakultetit _____.

Kësaj kërkesë i bashkëngjitet:

- Kopja e kartës së identitetit/pasaportës;
- Kopja e noterizuar e diplomës/gradës/titullit që unë zotëroj;
- Vërtetimi i qendrës time të punës;
- Vërtetimi që nuk kam marrë masë disiplinore.

Autorizim: Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre.

Shënim: Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij formulari do të bëhet në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar. Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi penale sipas ligjit dhe passjell përjashtimin tuaj nga çdo procedurë e mëtejshme.

Aplikuesi

Emër, Mbiemër, Firmë

U dorëzua më datë ___/___/_____, pranë Zyrës së Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore/P-A.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE DHE INFORMACIONIT, P/A

KËRKESË PËR KANDIDIM

**PËR ANËTAR TË KOMISIONIT TË MBARËVAJTJES SË
VEPRIMTARISË DHE MARRËDHËNIEVE ME STUDENTËT
(STUDENTË)**

Unë, i/e nënshkruar/i/a _____, lindur më ___/___/_____, në _____, të rrethit _____, gjinia _____, student/e në programin e studimit _____, të Fakultetit _____, paraqes kërkesën time për të kandiduar për anëtar të Komisionit të Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët, në zgjedhjet e muajit prill 2023, si përfaqësues i Studentëve të Fakultetit të _____ në këtë Komision.

Kësaj kërkesë i bashkëngjitet:

- Kopja e kartës së identitetit/pasaportës;
- Vërtetimi që jam student (viti i I-II bachelor dhe viri i I – II master);
- Lista e notave që dëshmon mesataren e notës (mbi tetë) të provimeve të dhëna deri në momentin e kandidimit;
- Vërtetimi që nuk kam marrë masë disiplinore.

Autorizim: Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre.

Shënim: Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij formulari do të bëhet në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar. Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi penale sipas ligjit dhe passjell përjashtimin tuaj nga çdo procedurë e mëtejshme.

Aplikuesi

Emër, Mbiemër, Firmë

U dorëzua më datë ___/___/_____, pranë Zyrës së Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore/P-A.



